



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 25-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 26. 11. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës

4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Shkelzen, Hajdini, drejtor i DEZH
6. Rasim Hasani, drejtor i DKA
7. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
8. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
9. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
10. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
11. Bekim Shabani, drejtor i DRKS
12. Vlorë Limani-Hajnuni DSHMS
13. Vlorë Krasniqi, zyrtarë ligjorë
14. Safet Krasniqi, auditor i brendshëm
15. Bukurie Zejnullahu, zyra e informimit
16. Besart Troshupa, zyra e informimit
17. Kimete Jashanica, OSBE
18. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
19. Haki Avdiu, zyrtar i teknologjisë
20. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit. Pastaj Kryesuesi ftoj që të bëhet një minut heshtje për shkak të viktimave nga tërmeti i ndodhur në Shqipëri.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të Kuvendit.
2. Propozim vendimi për miratimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal 2019-2023 në Komunën e Lipjanit
3. Rregullore për Taksat Komunale
4. Rregullore për Tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020
5. Rregullore mbi transparencën në Komunën e Lipjanit
6. Propozim vendim për miratimin e planit komunal për Riintegrimin e Qëndrueshmëm të personave të riatdhesuar 2019-2022
7. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare
8. Prezentimi i raportit të punës i Sektorit për Personel për periudhën Janar-Tetor 2019
9. Informatë mbi rishikimin e planit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit të jashtëm dhe rishikimin e planit të zbatimit të auditorit të brendshëm.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se 30 vota për, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Lulzim Rrustemi, uroj që pjesa e tërmetit të kalojë sa më mirë dhe të ketë sa më pak viktima. Kam një kërkesë për inspektoriatin që të shikoj te "Pofixi" dy kompani "Kosova asphalt" dhe "Bageri" po shkaktojnë pluhur të madh është mirë inspektoriatin me i kontrollu. Pyetja e dytë të shtegu i bicikletave ka qenë një veprimtari private por ajo është zhvendosur a ka qenë aty pronë komunale.

Ramiz Qeriqi, së pari ngushëllime për viktimat e rënë në Shqipëri. Të gjithë shqipëtarëve ju uroj festën e nëntorit. Kam disa kërkesa për t'i ngritur: banorët e fshatit Grackë e Vjetër kërkojnë që të ndërtohet një shkollë ose të ndërtohet nënkalimi, pasi që çdo herë po duhet një prind t'i përcjell nxënësit. Drunjët dekorativ rreth hekurudhës janë tharë a jep llogari dikush për ta. Unë e kam ngritur edhe më herët çështjen e prodhimit të naftës prapa ABE-së nga një kompani dhe ajo vazhdon prap. Dhe aty gjatë vikendeve kundërmon një erë e keqe dhe është një kërkesë e qytetarëve që aty të ndërhyhet.

Albulena Kelmendi, edhe unë në emër të grupit parlamentar të W-së shprehu ngushllimet të gjithë atyre që kanë humbur të dashurit e tyre gjatë termetit në Shqipëri. Çështja që do ta ngris është shqetësim i përgjithshëm që ka të bëjë me përdorimin e narkotikëve në qytetin e Lipjanit e në veçanti në shkollat e Lipjanit. Është mirë që të ketë shtim të policëve civil nëpër shkolla por edhe kontrolla sistematike pasi që është një shqetësim. Po ashtu kërkoj nga DKA-ja që të shtohet presioni ndaj psikologëve.

Nehat Tërpeza, kam dy çështje a janë vendosur kamerat në të gjitha pjesët më të frekuentuara të qytetit. Dhe çështja e dytë në njërën nga seancat e Kuvendit kam ngritur një shqetësim për numrin e nxënësve që po e braktisin shkollimin. Pyetje për DKA-në sa është numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën? Pasi që ka nxënës që rrinë në shtëpi dhe nuk vijnë në shkollë.

Arben Salihu, pasi që jemi në festat e fundvitit kërkoj nga drejtoria përkatëse të nxjerret një urdhëresë për përdorimin e mjeteve piroteknike. Ku sipas statistikave ka pasur të lënduar gjatë përdorimit të këtyre mjeteve por janë përdorur edhe nga persona të mitur dhe kërkoj që të nxirret një shkresë dhe të ndalohet nga personat e pa autorizuar. Çështja tjetër ka të bëjë me policinë e vendit e cila po vonohet në intervenime.

Imri Ahmeti, kryetar i Komunës, tha se edhe ne bashk ndjejmë dhimbjen për viktimat nga tërmeti në Shqipëri dhe lutemi që të kemi sa më pak viktima.

Te çështja e ambientit sa e di une pëlqimet i marrin nga Ministria e ambientit. Por do të shohim se a e ndotin këto dy kompani ambientin edhe pse njëra është në teritorin e komunës së Graçanicës. Te çështja e shtigjeve të bicikletave e kemi identifikuar atë prone dhe ajo një pjesë do të përfundoj këtë vit ndërsa pjesa tjetër në vitin e ardhshëm. Nevoja e fshatit Grackë për një shkollë është duke u rritë çdo ditë dhe ne do të shohim mundësinë për ndërtimin e një objekti shkollor në vitet në vijim. Ndërsa mbrapa ABE-së nuk ekziston diçka e tillë aty. Problemi i narkotikëve është problem shqetësues po ashtu edhe braktisja e shkollave nga nxënësit dhe në seancat në vazhdim do të bisedojmë me përgjegjësit e Lipjanit dhe do t'i marrim hapat që këto dukuri të zvogëlohen. Po ashtu shqetësuese është edhe dukuria e vjedhjeve që është në rritje. Edhe unë pajtohem që të ndalohen mjetet piroteknike e ditëve tjera, të lejohen vetëm natën e Vitit të Ri. Qyteti i Lipjanit është i mbuluar mire nga kamerat dhe janë të mbuluara pjesët kryesore të qytetit.

Ramiz Qeriqi, mbrapa ABE-së kalojnë afër shtëpive me do cisterne ku me do vaj bëjnë prodhimin e naftës dhe ato kundërmojnë një erë të keqe. Nuk m'u dha prgjigjja për drunjët që nuk janë zënë rreth hekurudhës.

Imri Ahmeti, unë nuk i mbuloj veprimet ligjore të askujt dhe ajo që ka qenë aty është spostu moti. Ndërsa për drunjët dekorativ ndoshta janë tharë por ne i mbjellim përsëri.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes 24-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për

Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 24-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendimi për miratimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal 2019-2023 në Komunen e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdinit, drejtor i DEZH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi .

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, e përgëzoj drejtorin për këtë dokument dhe mund të them që është një prej dokumenteve më të mira që kanë ardhur në këtë Kuvend si për nga aspekti përmbajtësor po ashtu edhe akademik. Ne në KPF i kemi dhënë vërejtjet tona rreth qytezës së Janjevës dhe shtepisë së at Shtjefan Gjeçovit. Është një strategji që ka kërkuar përkushtim të madh për t'u realizuar. Ne si grup jemi të gatshëm me dhënë ndihmën pa kushte rreth ndonjë rekomandimi apo sygjerimi. Ne kemi potencial të bollshëm dhe presim në të ardhmen të ketë investime të huaja. Dhe shpresojmë që mos të jetë vetëm në letër por të zbatohet edhe në praktikë. Një strategji e tillë i ndihmon të hyrave vetanake të komunës së Lipjanit por edhe turizmit në Lipjan. Në shkollën profesionale "Adem Gllavica" duhet të ju bëhet njoftime që nxënësit që shkojnë në ato shkolla të mbahet edhe praktika profesionale pasi që në shumicën e rasteve nxënësit në ato shkolla po regjistrohen për shkak se nuk po munden me u regjistru në gjimnaz.

Ganimete Qeriqi, edhe unë i shprehi ngushllimet për viktimat e humbura gjatë tërmetit në Shqipëri. Po ashtu ua uroj festat e nëntorit të gjithëve. Ju përgëzoj për këtë strategji, por kam një pyetje a mendohet ndonjëherë në Lipjan të bëhet nxemja qendrore siç ka qenë më herët. Po ashtu përveç monumenteve siç janë: Janjeva, parku i Blinajës a mendohet t'i bashkohen kësaj strategjie edhe momentet e pas luftës të ruhen si trashëgimi kulturore dhe unë e kam një propozim që në fshatin Krojmir shtëpia e Mehdi Qeriqit e cila ka kontribua shumë të hyjë në këto monumente.

Majlinda Sylejmani, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë strategji. Komuna jonë ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kjo na bënë të kemi potencial për zhvillim ekonomik sa më të mirë. Po ashtu kemi potencial të mirë për zhvillimin e turizmit siç janë Janjeva dhe parku i Blinajës. Me këtë plan do të rritet promovimi dhe përmes këtij do të rritet aftësia e të bërit biznes. Me këtë strategji komuna jonë synon t'i përkrah idetë. Shpresoj që kjo strategji ka me pas sukses dhe ka me u marrë shembull nga dikasterët tjerë.

Shkelzen Bislimi, deshta me pyet se çka ka ndodh me këtë zyre për informimin e turistëve që është e vendosur në qytet.

Afrim Miftari, uroj për punën ekipore të komisionit së bashku me drejtorin që kanë bërë këtë strategji pasi që ky dokument ka pas nevojë për përkushtim. Shihet që nuk është një dokument statik por në etapa mund të ndryshohet. Sipas kësaj strategjie është përkushtimi i sektorit privat me sektorin e arsimit. Te investimet shihet se janë të cekura vendore të diasporës dhe ndërkombëtare. Për drejtimet profesionale duhet të bëhet reklamim më i madh që nxënësit të shkojnë në ato drejtime. Sfidë për këtë strategji ka me qenë kthimi i pronësisë së Shpellës së Gadimes në pronësi të komunës së Lipjanit. Ne si grup e përkrahim këtë strategji me shpresë që kjo strategji do të zbatohet në praktikë.

Bashkim Budakova, edhe unë uroj për këtë strategji që të zbatohet e në veçanti nga donatorët e jashtit. Por është një gabim teknik në këtë strategji në faqe 12-të te pozita

geografike e Lipjanit ku te kufizimi është përmendur 2 herë komuna e Ferizajit. Po ashtu i njëjti gabim teknik është edhe te web faqja e komunës.

Lulzim Rrustemi, kemi para vetes njërën ndër dokumentet më të rëndësishme të Komunës së Lipjanit, një nga dokumentet më voluminoze dhe më të strukturuar mirë të komunës së Lipjanit. Është në përputhje me shumë dokumente edhe të nivelit qendrorë edhe të nivelit lokal dhe del një strategji e kompletuar. Ka përfshi 5 objektiva kryesore dhe brenda këtyre objektivave janë shqyrtu të gjitha problemet me të cilat merret Komuna e Lipjanit. Në këtë strategji janë përfshi zonat komerciale por është dashtë të përfshihet edhe një pjesë në mes të Kraishtës, Godancit dhe Varigovcit që kufizohen me fshatin Godanc të Shtimes e cila është një pjesë që ka mbi 300 hektarë dhe do të na shërbej për tërheqjen e investimeve të huaja. Në këtë strategji është përfshi edhe diaspora por nuk duhet vetëm në javën e diasporës por ata kanë kërkuar që të jenë edhe pjesë e debateve. Është mirë të jetë edhe një konferencë vjetore, investive për diasporën e Komunës së Lipjanit në mënyrë që ata me pas nxitje për me ardh me investu në Kosovë. Te objektiva e dytë fuqizimi i sektorit privat dhe bashkëpunimi me sektorin e arsimit. Sfidë e kësaj strategjie është zvogëlimi i papunësisë në Komunën e Lipjanit. Te uji i pijshëm duhet të jetë afatëshkurtur dhe të vazhdohet në hulumtimin e puseve pasi që Komuna e Lipjanit sa i përket ujit të pijshëm do të ketë problem. Te kultura nuk i është kushtuar rëndësi Balcës së bashku me Kleçkë e Divlakë. Po ashtu te pjesa ku janë Dëshmorët e Kombit e disa të tjerë të futetn edhe Martirët e luftës. Uroj që kjo strategji të zbatohet në të ardhmen e të mos jetë vetëm në letër.

Nazmi Krasniqi, është një dokument i përpiluar mirë por është me rëndësi që të ketë buxhet për implementimin e kësaj strategjie. Sa i përket migrimit të qytetarëve jasht shtetit në këtë strategji është shkruar pak. Sa ka qenë migrimi në vitet e fundit në Komunën e Lipjanit a keni ndonjë statistikë.

Ramiz Qeriqi, më vjen mirë që në këtë strategji janë përfshi Gadimja, Janjeva, Parku i Blinajës por kam një kërkesë që në këtë strategji të përfshihet edhe një hartë e historisë së fundit të UÇK-së. Ku shihet kush ka ndihmu, ku na kanë rënë dëshmorët, ku na kanë rënë martirët.

Ganimete Qeriqi, pak më herët më iku nga mendja thash shtëpia e Mehdi Qeriqit ka qenë aty ku ka qenë shtabi i përgjithshëm, ndërsa po e përmirësoj ka qenë shtabi përgjithshëm i Lipjanit.

Shkelzen Hajdini, ju falenderoj të gjithëve për këtë strategji për kontributin që keni dhënë. Unë kam një vërejtje te plani i veprimit te strategjia që të shikohet forma e kostos së veprimit. Po ashtu propozoj që te burimet e financimit të përfshihet partneriteti publiko privat. Po ashtu propozoj që të shtohet edhe pak tekst të shtohet për Janjevën. Pajtohem që edhe te burimet e ujit nëse na lejohet mundësia nga 2027 të ofrohet në 2023 ose 2022. Si dhe të përfshihen edhe martirët e luftës por edhe konferenca e donatorëve. Furnizimi me ngrohje qendrore e kemi menduar për të ardhmen. Qendra informuese turistike është funksionale, ndërsa sa i përket migrimit nuk kemi ndonjë informatë por do të shohim nga enti i statistikave të Kosovës.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin me propozimet të cilat i lexoi drejtori dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2019-2023 NË KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023 në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023 në Komunën e Lipjanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Lipjanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Rregullorja

III

Rregullore për Taksat Komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini, drejtor i DA-ës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu, kam një pyetje për kioskat që janë në pronë publike në cilën pjesë të taksave hyjnë?

Arben Salihu, kërkoj një sqarim nga drejtori te faqja 6 neni 9 pika 4.2 te OJQ-të ku thuhet lirohen nga pagesa pse janë futë OJQ-të.

Lumturije Bytyqi-Hasani, në parim ne si grup e përkrahim këtë propozim Rregullore por e kam dhënë një propozim edhe në KPF që të përfshihen edhe bankomatët të cilët mund të përfshihen në pronë publike në të ardhmen dhe ne nuk kemi një bazë ligjore ku mund t'i qitet taksë shtesë kompanive në fjalë.

Shkelzen Hajdini, kioskat rregullohen me Rregulloren për pronën publike, ndërsa bankomatët nuk janë trajtu.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

IV

Rregullore për Tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, kush e bën komisionin për vlerësimin e pronës.

Latif Ramadani, komisionin e bënë Ministria e Financave, departamenti i tatimit në pronë dhe ai komision e bënë vlerësimin e pronës që është i caktuar nga niveli qendror.

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

V

Rregullore mbi transparencën në Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Olluri, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije-bytyqi-Hasani, si rregullore është mjaft e detalizume dhe nuk dallon shumë nga Rregullorja që na ka ardhur më herët, është mirë që është shtu neni 8 pasi që më herët qytetarët kanë bërë peticione dhe asnjëherë nuk kanë ardhur në Kuvend.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se çdo akt i nënshkruar do të publikohet pasi që është detyrim i yni i përbashkët. Ndërsa sa i përket peticioneve në Kuvend do të vijnë vetëm ato peticione të cilat lejohen me Ligj.

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

Pastaj Kryesuesi dha pauz prej orës 12⁰⁰ deri në ora 13³⁰

VI

Propozim vendim për miratimin e planit komunal për Riintegrimin e Qëndrueshmëm të personave të riatdhesuar 2019-2022

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Radmilla Simionoviq, shefe e ZLK-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, disa sqarime që i kemi kërku në KPF na ka njoftuar se i ka rregulluar dhe ne si të tillë si grup e përkrahim.

Hyra Bytyçi, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë plan.

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe ne grup parlamentar e përkrahim këtë plan.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR 2019-2022

Neni 1

MIRATOHET , Plani komunal i veprimit për riintegrimin e qëndrueshmëm të personave të riatdhesuar 2019-

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani komunal i veprimit për riintegrimin e qëndrueshmëm të personave të riatdhesuar 2019-2022

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra Lokale e Komunës për Komunitete.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

VII

Vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shefqet Amerllahut, drejtor i DBPZHR-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza, ky propozim është i mirë pritur dhe ne si grup parlamentar i jepim mbështetje. Organizata Katar e ka shtri aktivitetin në të gjithë teritorin e komunës së Lipjanit me hapjen e puseve ku nuk ka fshat që nuk ka përfitues. Por kjo është arritur edhe falë punës së palodhshme të zyrtarëve komunal dhe punë të tilla të mira ndikojnë që edhe organizata tjera të bashkëfinancojnë në komunën tonë.

Afrim Miftari, edhe ne si grup parlamentar e mbështesim këtë propozim vendim pasi që kjo është marrëveshje bashkëpunimi në mes të komunës së Lipjanit dhe organizatës KATAR dhe ne e falenderojmë organizatën KATAR për bashkëpunimin.

Lulzim Rrustemi, edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe e mbështesim por kam një pyetje për drejtorin se cilat janë kriteret që duhet plotësuar për të përfituar dhe a janë zgjedh fituesit.

Shefqet Amerllahu, kriteret i cakton vet organizata e KATARIT, ndërsa përfituesit janë zgjedhur.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, 1 apstenim aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 11,731.00 € (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një euro), me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit për sigurimin e serrave bujqësore, motokultivatorëve, tufë delesh, shoqëri bletësh me qëllim të fuqizimit ekonomik të këtyre familjeve

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën II të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Bashkëpunimit 1-320-48969 të datës 23.07.2019 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “QATAR CHARITY” në të cilën përcaktohet që nga shuma e përgjithshme e projektit, Komuna e Lipjanit do të participojë me 10% nga vlera e projektit .

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës-kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural .

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Shtesë: Vendimi.

VIII

Prezentimi i raportit të punës i Sektorit për Personel për periudhën Janar-Tetor 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, sa të punësuar kontratë mbi vepër janë në komunën e Lipjanit.

Avni Olluri, gjithësej janë të punësuar 8 punëtorë (zyrtarë)

X

Informatë mbi rishikimin e planit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit të jashtëm dhe rishikimin e planit të zbatimit të auditorit të brendshëm.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,¹⁵

**Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi**